

**Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës  
trajtimin ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues**

Adresa: Bulevardi: “Zhan D’Ark” Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/343  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

**Nr. K4/I30-2 Prot.**

**Tiranë \_30\_/\_\_07\_/2025**

**Nr. Dok. 202502633/3**

**Lënda:** *Rekomandime për inspektimin e kryer në ambientet e shoqërimit në Komisaritin e Policisë Librazhd.*

**Drejtuar:** **Z. Elton HALILI**  
**Shef i Komisaritatit të Policisë Librazhd**

**LIBRAZHD**

**Z. Fatmir HOXHA**  
**Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan**

**ELBASAN**

**Për dijeni:** **Z. Ilir PRODA**  
**Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit**

**TIRANË**

*Të nderuar,*

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin e deritanishëm midis institucioneve tona, si dhe duke vlerësuar angazhimin për punën e stafit të institucionit që ju drejtoni, në vijim po ju njohim me gjetjet dhe rekomandimet nga inspektimi i kryer në ambientet e privimit të lirisë së personit në Komisaritin e Policisë Librazhd nga Institucioni i Avokatit të Popullit.

Avokati i Popullit, në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, trajtimin ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, në vijim Mekanizmi Kombëtar, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, kreu një inspektim në Komisaritin e Policisë Librazhd në datën 18.04.2025, sipas një plani inspektimi vjetor të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin z. Ahmet Prençi, Komisioner i Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, z. Hazbi Selita dhe z. Vullnet Topalli me detyrë Nd/Komisionerë pranë Mekanizmit Kombëtar.

Qëllimi i inspektimit ishte vlerësimi i përgjithshëm i respektimit të të drejtave themelore të arrestuarve, të ndaluarve dhe të shoqëruarve, të cilat ju garantohen me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kodin e Procedurës Penale, ligjin nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit”, si dhe me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave themelore të personave të privuar nga liria. Inspektimi ishte paparalajmëruar.

Bazuar në legjislacionin vendas dhe standardet ndërkombëtare, MKPT mund të vizitojë në çdo kohë dhe pa paralajmërim, të gjitha vendet ku mbahen personat e privuar nga liria, përfshirë organet e policisë në nivel vendor, burgjet, qendrat e pritjes provizore të migrantëve të parregullt, qendrat ku mbahen shtetasit e huaj të privuar nga liria dhe azilkërkuesit, si dhe institucionet psikiatrike e shtëpitë e të moshuarve.

Në këtë kuadër, grupi i inspektimit verifikoi zbatimin e kushteve dhe kritereve ligjore të shoqërimit nga punonjësit e policisë të komisariatit, inspektoi ambientet që ndodhen në mjedisin e shoqërimit, u kontrollua dokumentacioni që ndodhej në zyrën e informacionit, si dhe procedurat që ndjekin punonjësit e policisë sipas kërkesave të parashikuara në procedurat standarde të punës *“Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”* miratuar me Urdhrin nr. 894, datë 19.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, si dhe u verifikua gjithashtu edhe zbatimi i rekomandimeve të MKPT-së nga inspektimi i mëparshëm i kryer në ambientin e shoqërimit të Komisariatit të Policisë Librazhd<sup>1</sup>.

Avokati i Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues dhe nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga inspektimi i mëparshëm, ka detyrimin kushtetues dhe ligjor t’ju parashtojë konkluzionet përfundimtare, duke ju referuar si më poshtë vijon:

### **Shënime të përgjithshme**

Në përputhje me metodologjinë e zhvillimit të inspektimit në institucionet ku mbahen e trajtohen shtetas të privuar nga liria, grupi inspektues u takua me shefin e Komisariatit të Policisë Librazhd z. Elton Halili, i cili u vu në dijeni lidhur me qëllimin e inspektimit.

Në vijim të takimit, z. Halili informoi grupin e inspektimit, mbi masat e marra për realizimin e rekomandimeve të lëna nga Avokati i Popullit, referuar inspektimit të mëparshëm lidhur me përmirësimin e kushteve të ambienteve të shoqërimit të këtij komisariati, sipas procedurave standarde dhe për rritjen e performancës së punonjësve të policisë për respektimin e të drejtave ligjore të shtetasve të shoqëruar.

Grupi inspektues, pasi mori informacionin e nevojshëm, i shoqëruar nga Shefi i Rendit, inspektoi në vend gjendjen e dhomave të shoqërimit, kushtet infrastrukturore dhe materiale të tyre, si dhe u njoh dhe administroi kopje të dokumentacionit ku pasqyrohen veprimet e kryera me personat e shoqëruar, si dhe vizitoi zyrat e punës së oficerëve të Policisë Gjyqësore, në lidhje me praninë e sendeve që ekspozojnë dhunë gjatë kryerjes së veprimeve procedurale për marrjen në pyetje të personave të shoqëruar.

Theksojmë se, shefi i komisariatit dhe punonjësit e tjerë të policisë, me të cilët kontaktoi grupi i inspektimit u treguan bashkëpunues gjatë inspektimit.

---

<sup>1</sup> Shkresë nr. K4/I21-2 prot., datë 20.06.2024 *“Rekomandim për inspektimin e kryer në ambientin e shoqërimit të Komisariatit të Policisë Librazhd”*.

Në Komisarlatin e Policisë Librazhd, nga informacioni i grumbulluar gjatë kryerjes së inspektimit në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin e kaluar<sup>2</sup>, rezultoi se:

1. Ishte zbatuar rekomandimi, për hidroizolim të tarracës të godinës së dhomave të shoqërimit të Komisarlatit të Policisë Librazhd, për eliminimin e lagështirës së dhomave të shoqërimit në këtë institucion.
2. Ishte zbatuar rekomandimi, për mirëmbajtjen e dhomave të shoqërimit, lyerjen e tyre dhe garantimin e kushteve higjieno-sanitare në dhomat e shoqërimit dhe të tualeteve në ambientet e Komisarlatit të Policisë Librazhd, si dhe rregullimin e bravave të dyerve për mbylljen e tyre.
3. Ishte zbatuar rekomandimi për personat që kanë përgjegjësi për organizimin e punës për mirëmbajtjen dhe pastërtinë të ambienteve të Komisarlatit të Policisë Librazhd.
4. Ishte zbatuar rekomandimi, për plotësimin me korrektësi në *“Regjistrin për evedentimin e të dhënave të të shoqëruarve”* të rubrikës *“Të dhëna për njoftimin e familjarëve/afërmeve”*.
5. Ishte zbatuar pjesërisht rekomandimi, për pajisjen e dhomës së shoqërimit me orenditë e nevojshme si karrige, që shërbejnë për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar, të cilat ishin të fiksuara në dyshe dhe të pa lëvizshme, por jo për tavolina sikurse përcaktohet në procedurat standarde.

Ndërkohë, grupi i inspektimit konstatoi se:

1. Nuk ishte zbatuar rekomandimi, për gjetjen e fondeve për ndërtimin e dhomave të shoqërimit në Komisarlatin e Policisë Librazhd, sipas kriterëve të parashikuara në Kreun VII, pika 4 të procedurave standarde *“Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”* miratuar me Urdhrin nr. 894, datë 19.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, për ndërtimin e ambienteve të përshtatshme, dinjitoze, të pajisura me orenditë e nevojshme për qëndrimin në dhomat e shoqërimit të ndara më vete për persona të rritur, femra dhe të mitur në konflikt me ligjin dhe mos ndërtohen komisarlate që nuk janë në përputhje me procedurat standarde *“Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e Policisë së Shtetit”*.
2. Nuk ishte zbatuar rekomandimi, për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera vëzhguese në korridorin e ambientit të dhomave të shoqërimit në Komisarlatin e Policisë Librazhd.
3. Nuk ishte zbatuar rekomandimi, për krijimin e një zyre për intervistimin apo marrjen në pyetje të shtetasve gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e Policisë Gjyqësore, si dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera audio-vizive në këtë zyrë.
4. Nuk ishte zbatuar rekomandimi, për afishimin në ambientin e shoqërimit dhe në zyrën e informacionit të komisarlatit, të listës së psikologëve të miratuar nga Urdhri i Psikologut, Tiranë.
5. Nuk ishte zbatuar rekomandimi, për krijimin e zyrave të posaçme për intervistimin e personave të mitur, duke ofruar një ambient të përshtatshëm që duhet të jetë i rregulluar në mënyrë të posaçme për zhvillimin e bisedave me fëmijët.

---

<sup>2</sup> Kthim përgjigje të shkresës tonë nr. 2483/1 prot, datë 13.09.2023 nga Komisarlati i Policisë Librazhd.

6. Nuk ishte zbatuar rekomandimi, për krijimin më vete të dhomës për mbajtjen e provave materiale dhe largimin nga zyrat e punës së oficerëve të Policisë Gjyqësore të sendeve të cilat mund të ekspozojnë dhunë psikologjike/fizike tek personat me të cilët ata kryejnë veprime procedurale.

Në përfundim të inspektimit, grupi monitorues konstatoi se, në ambientet aktuale në Komisaratin e Policisë Librazhd, vazhdonin të ishin të pranishme disa problematika dhe konkretisht:

### **Ambientet e shoqërimit dhe kushtet e tyre**

Ambienti i shoqërimit në Komisaratin e Policisë Librazhd, **nuk** ishte i ndërtuar sipas kërkesave të ligjit nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit”, dhe procedurave standarde “*Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë*”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 894, datë 19.07.2022, ku parashikohet se dhomat e shoqërimit duhet të jenë me sipërfaqe dhe hapësira të bollshme për qëndrim, si dhe të ndara më vete për persona të rritur, për femra dhe të miturit<sup>3</sup>.

Mjedisi i shoqërimit ndodhej në katin e parë të ndërtesës dhe kishte 2 (dy) dhoma shoqërimi për mbajtjen dhe qëndrimin e meshkujve, ndërsa dhoma tjetër përdorej për mbajtjen dhe qëndrimin e grave dhe të miturve në konflikt me ligjin. Dhomat e shoqërimit ishte me sipërfaqe dhe hapësirë të bollshme për qëndrimin ulur të personave, me kushte të përshtatshme dhe të pajisura me orënditë e nevojshme, si 1 (një) stol dhe 2 (dy) karrige të reja, të fiksuara në dysheme në mënyrë të palëvizshme, por mungonte tavolina sikurse përcaktohet në procedurat standarde<sup>4</sup>. Përmasat e dhomave të shoqërimit ishin me përmasa 4x3m dhe kishin kapacitet për mbajtjen dhe qëndrimin ulur për 4 persona, për secilën dhomë.

Mungesa e dhomës së shoqërimit për të miturit në konflikt me ligjin është një nga problematikat që paraqitet në këtë komisarati, duke sjellë si pasojë mos garantimin e lirive, të drejtave dhe standardeve që kanë të bëjnë me shoqërimin, mbajtjen dhe trajtimin në mjediset e policisë, si dhe nevojave fizike, profesionale dhe psikologjike, kur merren vendime që prekin ndonjë aspekt të ndalimit të tyre.

Dhoma e shoqërimit për të miturit në konflikt me ligjin duhet të ishte ndërtuar siç është parashikuar në Kreun VII, pika 4 të procedurave standarde “*Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë*”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 894, datë 19.07.2022.

Dritaret e dhomave të shoqërimit ishin të siguruara me skarë hekuri në pjesën e jashtme, me qëllim parandalimin e largimit apo arratisjes së personave të shoqëruar nga këto mjedise. Dritaret ishin me përmasa të tilla që krijojnë mundësinë e ajrimit dhe ndriçimit të plotë natyral. Gjithashtu kishte edhe ndriçim artificial që furnizohej nga rrjeti elektrik. Dera ishte prej druri, me mundësi për t’u mbyllur nga jashtë.

---

<sup>3</sup> Kreu VI, pika 4/e.1 të procedurave standarde “*Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë*”, ku thuhet se: “*Në njësitë Vendore të Policisë ndërtohen ambientet e shoqërimit të ndara më vete për personat madhorë, të mitur dhe femra, të cilat kanë sipërfaqe 16-20m<sup>2</sup>*”.

<sup>4</sup> Kreu VI, pika 4/f.1 të procedurave standarde “*Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë*”.

Në ambientet e dhomave të shoqërimit në Komisarlatin e Policisë Librazhd kishte sistem ngrohje/ftohjeje, me anë të kondicionimit sikurse parashikohet në procedurat standarde.

Mjediset e dhomave të shoqërimit ishin të mirëmbajtura dhe të pastra nga ana higjieno-sanitare. Ngjitur me dhomat e shoqërimit ndodheshin dy tualete, të ndara më vete për femra dhe meshkuj, me ujë të rrjedhshëm 24 orë dhe të pajisura me të gjitha mjetet e domosdoshme për këtë qëllim.

Gjithashtu, në anën e majtë të korridorit të dhomave të shoqërimit, ndodhej edhe një ambient tjetër i cili shërben si zyrë pune për Specialistin e Policisë së Zonës (SPZ) dhe njëkohësisht shërbente edhe për marrjen në pyetje/intervistimin e personave të shoqëruar. Ky ambient ishte i pajisur me tavolina, karrige dhe stola për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar, si dhe me orëditë e nevojshme si karrige dhe tavolina pune për specialistët e policisë, por nuk kishte të instaluar kamerat e monitorimit.

Në këtë komisarlat ende **nuk** ishte instaluar sistemi i monitorimit me kamera për mbajtjen në vëzhgim të korridorit dhe ambienteve të shoqërimit. Mbikëqyrja me kamera e mjediseve të komisarlateve, përveç mjediseve ku çenohet privatësia, është vlerësuar nga ana jonë si një proces thelbësor për tre arsye:

**Së pari**, mbikëqyrja me kamera ka një efekt parandalues për veprime të kundërligjshme që mund të kryhen nga vetë punonjësit e policisë së shtetit ashtu edhe nga ana e të shoqëruarve, të ndaluarve apo të arrestuarve.

**Së dyti**, mbikëqyrja me kamera dokumenton shumicën e ngjarjeve brenda ambienteve të komisarlatit, si dhe jep garanci për një gjykim objektiv dhe të paanshëm për masat disiplinore apo penale që duhet të merren ndaj individëve përgjegjës.

**Së treti**, dokumentimi filmik është një material mbi të cilin mund të konsultohen mjaft të dhëna apo pretendime për trajtimin e të shoqëruarve, të ndaluarve apo të arrestuarve dhe mund të nxirren përfundime të vlefshme dhe të paanshme në rekomandimet përkatëse që hartojnë institucionet monitoruese të pavarura. Vlen të theksohet se ata shërbejnë për të garantuar besimin e qytetarëve te Policia e Shtetit.

Në kushtet e vendndodhjes së komisarlatit, si dhe për të garantuar sigurinë e personave të shoqëruar, është i domosdoshëm instalimi i sistemit të kamerave në korridoret dhe ambientet e brendshme të dhomave të shoqërimit siç parashikon Urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 894, datë 19.07.2022 procedurat standarde *“Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”*, ku thuhet se: *“Të gjitha ambientet e shoqërimit monitorohen me sisteme të kamerave (përfashtojnë tualetin) si ambientet e brendshme të dhomave të shoqërimit, korridori i tyre dhe pjesa e jashtme e dhomave të shoqërimit, të cilat lidhen dhe trasmentojnë pamje/imazhe në monitor të vendosur në ambientin e shoqërimit të sallës së komandimit/shërbimit të informacionit të DPV, komisarlate, dhe stacionet e policisë”*.

Në Komisarlatin e Policisë Librazhd gjatë periudhës **01.01.2025** deri më **18.04.2025** ishin të shoqëruar dhe të evidentuar në regjistrin e shoqërimit **65** persona, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 19 dhe 25/1 të ligjit nr. 82/2024, “Për Policinë e Shtetit”, ku të gjithë të shoqëruarit ishin shtetas madhorë burra. Në momentin e inspektimit **nuk kishte asnjë shtetas** në dhomat e shoqërimit.

Sipas informacionit të punonjësve të policisë në këtë komisarjat, personat e shoqëruar nga policia informohen për të drejtat e tyre ligjore/procedurale, në mënyrë verbale që nga fillimi i privimit të lirisë me hyrjen në mjediset e komisarjtit, ndërsa karta me të drejtat në formë shkresore jepet nga OPGJ-ja në momentin e marrjes në pyetje. Mekanizmi Kombëtar në mënyrë të përsëritur ka rekomanduar institucioneve të privimit të lirisë dhënien e kopjes së kartës së të drejtave që në momentin e hyrjes në komisarjat, si një element që garanton informimin në kohë dhe respektimin e të drejtave të tyre ligjore, por ky rekomandim ende nuk është zbatuar nga disa institucione në praktikë.

Dhënia e kartës e të drejtave **në formë shkresore, që nga fillimi i privimit të lirisë, shërben për të siguruar informim të qartë në lidhje me të drejtat ligjore/procedurale që ata kanë.** Rekomandimi i MKPT-së, në përmbajtjen e tij nënkupton që karta me të drejtat që gëzojnë personat kur hyjnë në mjediset e policisë, **duhet t'u jepet edhe personave që mbahen në dhomat e shoqërimit**, pra që në momentet e para të privimit të lirisë. Pasi këtyre personave iu kufizohet liria deri në 5 orë (maksimumi) qëndrimi në dhomat e shoqërimit, ata merren në pyetje nga specialistët e policisë dhe kanë të drejtën për njoftimin e familjarëve të tyre, të drejtën për qasje me avokat mbrojtës, etj. Aktualisht, karta me të drejtat jepet vetëm në momentin kur i ndaluar/arrestuari merret në pyetje nga OPGJ-ja dhe hyn në dhomat e sigurisë.

Avokati i Popullit inkurajon pajisjen e qytetarëve me “Kartën e të drejtave” në rast shoqërimi në polici, që është një dokument me të cilin duhet të njihet çdo qytetar që shoqërohet në një komisarjat policie. Nëpërmjet “Kartës së të drejtave” qytetari informohet mbi të drejtat e tij përballë institucionit të Policisë së Shtetit në mënyrë që të jetë i ndërgjegjshëm për çdo formë abuzimi apo tejkalimi të kompetencave të punonjësve të policisë kundrejt tij.

“Karta e të Drejtave” i shërben jo vetëm qytetarit, por edhe vetë Policisë së Shtetit, për të mirëmbajtur besimin e qytetarëve tek ajo, për ta forcuar bindjen se ajo është një instrument profesional shërbyes dhe jo dhunues i qytetarëve, si dhe për të evidentuar e veçuar abuzuesit me uniformën e policisë.

Vendosja në dispozicion të çdo qytetari të “Kartës së të Drejtave” është një standard të cilin Avokati i Popullit kërkon vazhdimisht që të respektohet. Kjo praktikë është vlerësuar dhe nga Komiteti për Parandalimin e Torturës në vijim (CPT) i cili e përshendeti zhvillimin e kësaj praktike për kartën edhe thellimin e saj, duke kërkuar që punonjësit në zyrën e pranimit të sigurohen që të shoqëruarit duhet të shkruajnë e lexojnë dhe e kuptojnë përmbajtjen e kartës.

Më datë 05.05.2025, në media është raportuar se banorët e fshatit Hotolisht, në qytetin e Librazhdit, kanë dalë në protestë, pasi kanë kundërshtuar projektin e rrugës “Elbasan–Qafë Thanë”, e cila pritet të kalojë në mes të fshatit të tyre, duke shkaktuar dëme në shtëpi, biznese dhe toka bujqësore. Sipas raportimeve, është pretenduar se punonjësit e Policisë së Shtetit kanë penguar banorët që të protestojnë.

Në kuadër të garantimit të të drejtave dhe lirive themelore të individit, veçanërisht në rastet e kufizimit të lirisë, Institucioni i Avokatit të Popullit reagoi menjëherë pas raportimeve mediatike mbi një ngjarje të ndodhur në qytetin e Librazhdit.

Institucioni i Avokatit të Popullit, në përmbushje të misionit të tij kushtetues e ligjor për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit, nga veprimet dhe mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike ngriti grupin e punës, me qëllim verifikimin e situatës në vend, vlerësimin e veprimeve të punonjësve të policisë, respektimin e kuadrit ligjor në fuqi për të drejtën për të protestuar dhe procedurave standarde të punës së Policisë së Shtetit duke u fokusuar edhe në respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Grupi i monitorimit, mori ankesa nga banorët e fshatit Hotilisht, Librazhd në lidhje me shoqërimin e 4 të miturve në konflikt ligjin, me arsyetimin se kishin penguar qarkullimin e automjeteve rrugore, duke i marrë në pyetje pa praninë e prindërve. Pas administrimit të ankesës, grupi monitorues shkoi në Komisaratin e Policisë Librazhd për të verifikuar dokumentacionin përkatës në lidhje me shoqërimin e të miturve.

Gjatë këqyrjes së regjistrit për të miturit në konflikt me ligjin rezultoi se të miturit e shoqëruar nuk ishin regjistruar në këtë regjistër, por në librin e hyrje-daljeve në kundërshtim me procedurën standarde ku parashikohet se: *“Akti/veprimi i shoqërimit, detyrimisht, evidentohet e dokumentohet në sistemin elektronik, në regjistra, në formular dhe procesverbal. Procedurat e evidentimit të veprimeve që janë kryer me të shoqëruarin kryhen nga punonjësi i policisë që ka punuar dhe sqaruar çështjen, ndërsa hedhja e të dhënave në regjistrin dhe në sistemin elektronik të të dhënave kryhet nga punonjësi i policisë të shërbimit të informacionit në njësinë policore, dhe mos zbatimi i procedurës standarde nga persona përgjegjës për dokumentin e aktit të shoqërimit, përbën shkelje të rëndë disiplinore”*.

Grupi i inspektimit kërkoi informacion nga OPGJ-ja e Komisaratis të Policisë Librazhd në lidhje me procedurën e intervistimit të të miturve në konflikt me ligjin, i cili na informoi se procedura e intervistimit të të miturve në konflikt me ligjin është bërë në prani të psikologut dhe avokatit mbrojtës.

Për sa më sipër, të miturit në konflikt me ligjin, gëzojnë të drejtat e parashikuara, jo vetëm në Kodin e Procedurës Penale, por edhe të drejtat e posaçme të parashikuara në Kodin e Drejtësisë Penale për të Miturit. Kështu, në rastet e shoqërimit, ndalimit apo arrestimit të të miturve dhe shoqërimit të tyre në komisaratin, detyrimisht njoftohet familja, përfaqësuesi ligjor, mbrojtësi, dhe psikologu<sup>5</sup>. Në çastin e shoqërimit/ndalimit/arrestimit, të miturve u bëhet i qartë shkaku i kufizimit të lirisë dhe u komunikohen të drejtat dhe garancitë procedurale. Të miturit merren në pyetje nga specialistët e Policisë së Shtetit<sup>6</sup>, pasi janë njoftuar prindërit apo përfaqësuesi ligjor, mbrojtësi, si dhe psikologu, që do të thotë, se pyetja e të miturit mund të bëhet vetëm me pëlqimin dhe në praninë e përfaqësuesit të tij ligjor/procedural, psikologut dhe mbrojtësit të tij<sup>7</sup>.

Ne çmojmë se kryerja e një hetimi administrativ nga ana e këtij organi mbi këto episode, identifikimi i punonjësve përgjegjës të policisë që kanë kryer shkeljen dhe arritja në përfundime konkrete nga hetimi, është tregues i vendosmërisë së autoriteteve shtetërore

---

<sup>5</sup> Nenet 18 dhe 19, të ligjit nr.37/2017, “Kodi i Drejtësisë penale për të Mitur”.

<sup>6</sup> Neni 25, i ligjit nr.37/2017, parasheh në mënyrë të hollësishme, detyrimin e organeve kompetente, për marrjen e masave të duhura, për të siguruar, që: *“Personat, të cilët punojnë me të miturit, të kenë njohuritë e nevojshme, ndërgjegjësimin profesional më të lartë për mbrojtjen e të drejtave të të miturve në konflikt me ligjin, viktime ose dëshmitar”*.

<sup>7</sup> Neni 42, i ligjit nr.37/2017 “Kodi i Drejtësisë penale për të Mitur”.

për të forcuar përgjegjshmërinë e punonjësve të policisë gjatë ushtrimit të detyrës së tyre si dhe për të rritur performancën e këtij organi në publik.

Ndërkohë gjatë inspektimit të datës 18.04.2025, nga verifikimi i regjistrit të marrjes dhe dorëzimit të personave të shoqëruar dhe kopjeve të procesverbalit të veprimeve të kryera nga punonjësi i policisë me personin e shoqëruar, në rubrikën me shënimet në lidhje me ankesat/kërkesat e të shoqëruarve rezultoi se për vitin 2025 nuk kishte asnjë ankesë të regjistruar.

Sipas strukturës, Komisariati i Policisë Librazhd kishte në organikë 3 specialistë policie/OPGJ dhe 6 specialistë SPZ. Nga këqyrja e zyrave të specialistëve të policisë/OPGJ dhe ndihmës/specialistëve të policisë/SPZ nuk u gjetën sende, prania e të cilave mund të ekspozonte dhunë ndaj shtetasve që intervistohen/merren në pyetje. Gjatë inspektimit nuk u konstatua asnjë rast, apo u administrua ndonjë ankesë lidhur me ushtrim dhune apo trajtim degradues nga ana e punonjësve të Policisë së Shtetit.

Nga monitorimi, u evidentuan disa praktika të njëpasnjëshme të shoqërimit të personit në polici, ku rezultoi se, në përfundim të procedurave dhe veprimeve të kryera nga punonjësit e policisë të komisarariatit, mbahej “Procesverbali i veprimeve të kryera nga punonjësi i policisë me personin e shoqëruar” (*lidhja model Nr.3*) të procedurave standarde, një kopje e të cilit e firmosur i jepej personit të shoqëruar.

Në Komisariatin e Policisë Librazhd mungonte dhoma e mbajtjes së provave materiale dhe në mungesë të saj oficerët e Policisë Gjyqësore, sendet të cilat mund të ekspozojnë dhunë psikologjike/fizike tek personat me të cilët ata kryenin veprime procedurale i mbanin në zyrat e tyre, të cilat shërbejnë edhe për intervistimin e personave të shoqëruar/ndaluar.

Në kohën e kryerjes së inspektimit, sikurse u raportua edhe më lart nuk kishte asnjë person të shoqëruar në mjediset e komisarariatit, për rrjedhojë grupi i inspektimit nuk realizoi intervista lidhur me trajtimin që ju bëhet personave nga ana e punonjësve të policisë nga momenti i shoqërimit, gjatë kohës së qëndrimit në dhomat e shoqërimit, gjatë marrjes në pyetje apo intervistimit të tyre.

### **Ambientet e sigurisë dhe kushtet e tyre**

Në Komisariatin e Policisë Librazhd nuk kishte ambiente të sigurisë dhe personat e arrestuar/ndaluar, në përfundim të veprimeve procedurale nga ana e punonjësve të policisë, dërgohen menjëherë në "Bllokun e Sigurisë" në varësi të DVP-së Tiranë.

### **Regjistri i personave të shoqëruar dhe trajtimi i të shoqëruarve**

Gjatë inspektimit u konstatua se në Komisariatin e Policisë Librazhd, “Regjistri i evidentimit të dhënave për personat e shoqëruar” ishte i tipit “Model Nr. 1” konform me procedurat standarde “Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë” miratuar me Urdhrin nr. 894, datë 19.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe ishte i sekretuar. Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policisë sipas dispozitave të parashikuara në ligjin nr. 82/2024, “Për Policinë e Shtetit”, regjistroheshin në këtë regjister nga punonjësit e zyrës së informacionit.



### Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se:

Koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi e shtetasve ishte e ndryshme nga **nga 1 orë deri në 5 orë** në raste të veçanta. Rubrikat e regjistrit ishin plotësuar në mënyrë korrekte, me përgjegjësi dhe saktësi nga punonjësit e policisë.

Në këtë komisariat kishte regjistër për personat e arrestuar/ndaluar, ku evidentoheshin të gjitha rastet e ndalimeve dhe arrestimeve të kryera nga punonjësit e këtij organi, i cili ishte i sekretuar. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se, ishin 9 persona të arrestuar/ndaluar dhe në rastet e arrestimeve dhe të ndalimeve të personave të shoqëruar, ora e arrestimit/ndalimit përputhej me orën e momentit të shoqërimit të tyre në organin e policisë.

Në këtë komisariat kishte regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në nenin 24 të ligjit nr. 82/2024, “Për Policinë e Shtetit”, por gjatë vitit 2025 nuk ishte evidentuar asnjë ankesë apo kërkesë nga ana e këtyre personave.

Nga inspektimi u konstatua se Komisariati i Policisë Librazhd, ishte pajisur me një regjistër të posaçëm, vetëm për të miturit në konflikt me ligjin. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se gjatë vitit 2025 nuk kishte asnjë të shoqëruar të mitur në konflikt me ligjin<sup>8</sup>.

### **Ambientet e intervistimit**

Në Komisaratin e Policisë e Policisë Librazhd, oficerët e Policisë Gjyqësore i kryenin veprimet procedurale me shtetasit në zyrat e tyre të punës. Këto ambiente, përsa kohë shërbejnë edhe si zyra intervistimi apo për marrjen në pyetje të të shoqëruarve në konflikt me ligjin, **nuk** ishin të monitoruara me kamera, për mbajtjen në vëzhgim të sjelljes dhe veprimeve procedurale që kryejnë oficerët e Policisë Gjyqësore me këta shtetas.

Krijimi i zyrave të veçanta ku merren në pyetje shtetasit gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e Policisë Gjyqësore dhe instalimi i sistemit të monitorimit me kamera në këto zyra, është rekomandim i përsëritur në vite nga Avokati i Popullit referuar standardeve ndërkombëtare<sup>9</sup>, të cilat e konsiderojnë procesin e monitorimit filmik si një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve e arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e Policisë së Shtetit.

Ky standard ka gjetur rregullim tashmë edhe në procedurat standarde “*Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë*”, miratuar me Urdhrin nr. 894, datë 19.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, duke u shndërruar në rregull të detyruar për strukturat qendrore dhe vendore të Policisë së Shtetit. Në këtë

<sup>8</sup> Detyrim i përcaktuar nga ligji Nr.37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”.

<sup>9</sup> “Një sistem i monitorimit të vazhdueshëm i standarteve dhe procedurave të intervistave të policisë duhet vënë në zbatim, po ashtu; kjo kërkon një regjistrim të saktë të intervistave të personave në ambiente të policisë, të cilat, nëse është e mundur duhet të zhvillohen me pajisje regjistruese elektronike (audio dhe/video). Duhet të kërkohej që të regjistrohet në mënyrë sistematike koha kur ka filluar dhe mbaruar intervista, ndonjë kërkesë të bërë nga i ndaluari gjatë intervistës, si dhe të personave të pranishëm gjatë çdo interviste”. Raporti i CPT-së për Armeninë: CPT/Inf (2018) 31 [par.20]. <https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000016806bf46f>.

dokument shprehet qartë se, në mjedisin ku ndodhen dhomat e shoqërimit, duhet të krijohet dhe një dhomë për intervistimin/marrjen në pyetje të personave të shoqëruar para se të akomodohen/futen në dhomat e sigurisë të DVP/komisariatit të policisë (personat që do të arrestohen/ndalohen). Ky ambient përveç kushteve të përcaktuara për dhomat e shoqërimit duhet të plotësojë dhe kushtet për: *“Instalimin e sistemeve dhe pajisjeve për regjistrimin elektronik audio dhe video të të gjitha veprimeve procedurale që kryhen me personin e shoqëruar nga oficerët e Policisë Gjyqësore, para se personi të akomodohet në dhomat e sigurisë të DVP/komisariatit të policisë si i arrestuar/ndaluar”*<sup>10</sup>. Dokumentimi elektronik i intervistimit të personave të shoqëruar është një masë tepër efikase për parandalimin e dhunës psikologjike.

Në raportin drejtuar Qeverisë Shqiptare mbi vizitën e Komiteti për Parandalimin e Torturës CPT-së në Shqipëri të kryer në datat 4-15 maj 2023 është evidentuar qartë nevoja e krijimit të dhomave të intervistimit: *“Në fakt, një strukturë e tillë mund të sigurojë një regjistrim të plotë dhe autentik të procesit të intervistimit, duke lehtësuar në masë të madhe hetimin e çdo pretendimi për keqtrajtim. Ky fakt është në interes si të personave që janë keqtrajtuar nga policia, ashtu edhe të punonjësve të policisë që janë përballur me pretendime të pabaza se janë përfshirë në keqtrajtme fizike apo presione psikologjike.*

*Në parim, regjistrimi audio-vizual duhet të mbulojë të gjitha fazat e marrjes në pyetje nga policia, duke përfshirë dhënien e informacionit për të drejtat në fillim të intervistës. Kjo do të sigurojë që marrja në pyetje nga ana e policisë të kryhet në përputhje me ligjin dhe do të ndihmojë në parandalimin e çdo praktike të nënshtrimit të personave të ndaluar në marrje në pyetje joformale përpara marrjes në pyetje zyrtare”.*

***CPT inkurajon autoritetet shqiptare të zgjerojnë aplikimin e regjistrimit audio-vizual të intervistave të policisë për marrjen në pyetje të të gjithë personave të shoqëruar”***<sup>11</sup>.

Komisariati i Policisë Librazhd në kushtet aktuale nuk posedon hapësirë të posaçme për komunikimin apo intervistimin me persona të mitur, ndaj MKPT e konsideron me rëndësi të veçantë faktin se bisedat me fëmijët dhe pyetja e tyre duhet të realizohen në një ambient që duhet të jetë i përshtatur në mënyrë të posaçme për zhvillimin e intervistimeve me fëmijët, pasi nga intervistimi i tyre në kushtet aktuale mund të shkaktohen pasoja të rënda deri në trauma tek të miturit që janë në konflikt me ligjin.

## **Ndihma juridike dhe psikologjike**

Grupi i inspektimit konstatoi se në momentin e inspektimit, në dhomat e shoqërimit nuk kishte asnjë person të shoqëruar. Në mungesë të tyre, u intervistuan punonjësit e policisë që kryejnë veprime procedurale me personat e shoqëruar, ku rezultoi se, në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit madhorë nuk kishin mundësi financiare për të pajtuar avokat privat dhe kërkonin ndihmë juridike, atyre iu sigurohej asistencë ligjore apo mbrojtja me avokat, nga zyrat e avokatisë që funksionojnë në qytetin e Librazhdit.

---

<sup>10</sup> Kreu VI, pika 4/i.1.1 të procedurave standarde *“Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”*.

<sup>11</sup> Electronic recording of police intervistës (Regjistrimi elektronik i marrjes në pyetje nga ana e policisë) fq.13, <https://rm.coe.int/1680ae233b>.

Nga inspektimi u evidentua se, në zyrën e informacionit dhe ambientin e shoqërimit, nuk ishte e afishuar lista e avokatëve të miratuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë Tiranë. Nga informacioni, kjo listë **nuk** ishte dërguar në DVP Elbasan, e cila më tej duhet të vihet në dispozicion të komisariateve të policisë në varësi të saj.

Sipas informacionit, përgjithësisht avokati paraqitej në mjediset e policisë jo më vonë se 1 orë nga momenti i njoftimit nga personeli i shërbimit ose nga specialistët e policisë të ngarkuar për kryerjen e veprimeve procedurale me të shoqëruarin apo të arrestuarin e dyshuar për kryerjen e veprës penale. Në regjistrin ku evidentohen takimet e të shoqëruarve me avokatin mbrojtës, shënohej emri dhe mbiemri i avokatit, si dhe ora e takimit, por jo ora e njoftimit.

CPT gjatë vizitës inspektuese në Shqipëri të zhvilluar në periudhën 4-15 Maj 2023 në institucionet policore, në raportin dërguar autoriteteve të Qeverisë së Shqipërisë, përsa i përket masave mbrojtëse themelore kundër keqtrajtimit të personit (përkatësisht, e drejta e njoftimit për ndalimin dhe e drejta për avokat dhe mjek), ka konstatuar se: *“Delegacioni dëgjoi disa pretendime se oficerët e policisë kishin pranuar kërkesat e tyre për avokat kryesisht vetëm **pas një vonese të konsiderueshme**, në mënyrë që të mund t’i pyesnin ata në mënyrë joformale për veprën e dyshuar pa praninë e një avokati. Gjithashtu janë marrë ankesa se **avokatët kryesisht nuk kanë ofruar ndonjë ndihmë kuptimplotë**. Për më shumë, informacioni i mbledhur gjatë vizitës sugjeronte se ekzaminimi fillestar mjekësor i personave të ndaluar në përgjithësi ishte ende i kufizuar tek pyetjet për gjendjen e tyre shëndetësore, pa kryer një ekzaminim fizik”*.

Përsa më sipër, CPT ka rekomanduar që: *“Autoritetet shqiptare duhet t’u kujtojnë të gjithë oficerëve të policisë **detyrimin ligjor për t’i dhënë akses ndaj një avokati që nga fillimi i heqjes së lirisë së një personi**. Gjithashtu, duhet të ndërmerren hapa në konsultim me Dhomën e Avokatëve për t’u siguruar që avokatëve kryesisht t’u kujtohet **roli i tyre kyç në parandalimin e keqtrajtimit duke qenë të pranishëm në komisarariatet e policisë dhe duke ndërhyrë që në fillim të privimit të lirisë, duke përfaqësuar sa më mirë të munden interesat e personave që janë të mandatuar të ndihmojnë dhe, më konkretisht, duke ndërmarrë veprimet e duhura sa herë që ka tregues se persona të tillë janë keqtrajtuar (ose mund të jenë) keqtrajtuar nga policia**. Gjithashtu, duhet të ndërmerren hapa për të promovuar, në kuadrin e trajnimit fillestar dhe të vazhdueshëm të avokatëve, një kulturë ku **mosndjekja e akuzave për keqtrajtim policor të konsiderohet si joetike dhe joprofesionale**”<sup>12</sup>.*

Gjithashtu, u evidentua se në mjedisin e shoqërimit mungonte edhe lista e psikologëve e miratuar nga Urdhri i Psikologut në Tiranë. Pavarësisht kësaj, në rastet kur i shoqëruari apo i ndaluar/arrestuari ishte i mitur, psikologu sigurohej në bashkëpunim me Bashkinë dhe shkollën e mesme të qytetit të Librazhdit.

Në rastet kur të shoqëruarit paraqesin probleme shëndetësore, ata i shoqërojnë në Qendrën Shëndetësore Librazhd, për të marrë ndihmën mjekësore.

Gjatë inspektimit u konstatua se në korridoret e godinës dhe të ambientit të shoqërimit, të këtij komisarati ishin afishuar postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar në organin e policisë.

---

<sup>12</sup> [efaidnbmnnnibpcajpcglclefindmkaj/https://rm.coe.int/1680ae233b](https://efaidnbmnnnibpcajpcglclefindmkaj/https://rm.coe.int/1680ae233b)

Përsa më sipër, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike” dhe në bazë të nenit 21/b të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”, me qëllim zgjidhjen e problemeve të konstatuara gjatë këtij inspektimi,

### **REKOMANDOJMË:**

1. Marrjen e masave të nevojshme për gjetjen e fondeve për ndërtimin e dhomave të shoqërimit në Komisaratin e Policisë Librazhd, sipas kritereve të parashikuara në Kreun VII, pika 4 të procedurave standarde “Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë” miratuar me Urdhrin nr. 894, datë 19.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, për ndërtimin e ambienteve të përshtatshme, dinjitoze, të pajisura me orëditë e nevojshme për qëndrimin në dhomat e shoqërimit të ndara më vete për persona të rritur, femra dhe të mitur në konflikt me ligjin dhe mos ndërtohen komisarate që nuk janë në përputhje me “Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e Policisë së Shtetit”.
2. Marrjen e masave menjëhershme për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera vëzhguese në korridorin e ambientit të dhomave të shoqërimit në Komisaratin e Policisë Librazhd.
3. Marrjen e masave të nevojshme, për krijimin e një zyre për intervistimin apo marrjen në pyetje të shtetasve gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e Policisë Gjyqësore, si dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera audio-vizive në këtë zyrë.
4. Marrjen e masave nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, për të filluar hetimin administrativ ndaj punonjësit/ve të policisë në Komisaratin e Policisë Librazhd, të cilët me veprimet e tyre, qartazi kanë shkelur procedurat standarde që parashikon legjislacioni në fuqi, në rastet e intervistimit të të miturit në konflikt me ligjin, duke ceduar e cenuar të drejtat e fëmijës.
5. Marrjen e masave të menjëhershme, për zbatimin me rigorozitet të detyrimit për regjistrimin e çdo personi të shoqëruar në Komisaratin e Policisë Librazhd në regjistrin përkatës të personave të shoqëruar, sikurse përcaktohet në procedurat standarde.
6. Marrjen e masave, për hartimin e procedurave standarde për punonjësit e Policisë së Shtetit, për qasjen e tyre kundrejt fëmijëve në përputhje me standardet ndërkombëtare të adresuara për këtë qëllim, si dhe aktet ndërkombëtare e kombëtare në fushën e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës.
7. Marrjen e masave të nevojshme, për krijimin e zyrave të posaçme për intervistimin e personave të mitur, duke ofruar një ambient të përshtatshëm që duhet të jetë i rregulluar në mënyrë të posaçme për zhvillimin e bisedave me fëmijët.

8. Marrjen e masave të nevojshme, për pajisjen e dhomës së shoqërimit me tavolina të fiksuara në dysHEME dhe të pa lëvizshme, sikurse përcaktohet në procedurat standarde.
9. Marrjen e masave, për krijimin më vete të dhomës për mbajtjen e provave materiale dhe largimin nga zyrat e punës së oficerëve të Policisë Gjyqësore të sendeve të cilat mund të ekspozojnë dhunë psikologjike/fizike tek personat me të cilët ata kryejnë veprime procedurale.
10. Marrjen e masave të nevojshme, për afishimin në ambientin e shoqërimit dhe në zyrën e informacionit të komisariatit, të listës së psikologëve të miratuar nga Urdhri i Psikologut, Tiranë.
11. Marrjen e masave të nevojshme, për afishimin në ambientin e shoqërimit dhe në zyrën e informacionit të komisariatit, të listës së avokatëve mbrojtës të miratuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë.
12. Marrjen e masave të menjëhershme, për dhënien e kartës së të drejtave në formë shkresore personave të shoqëruar që në momentin e hyrjes së tyre në komisariat.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihem në dijeni brenda afatit **30 ditë** sipas nenit 22 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,*

**KOMISIONERI  
i Mekanizmit Kombëtar  
për Parandalimin e Torturës  
(MKPT)**

**Ahmet PRENÇI**

**d.v**